



REPUBLIKA E KOSOVË

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -XIV-TË ME RADHË E -IX- E RREGULLT E KUVENDIT TË
KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 30 dhjetor 2020

Mbledhja është mbajtur në lokalet e Hotelit "Amazona" në Milloshevë, duke filluar në orën 10:50.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Ali Januzi, Arta Ymeri, Basri Menxhiqi, Bahrije Ademi Murati, Fatmire Saraçi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Faton Shabani, Fitim Halili, Gresa Muli, Gentiana Rama, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Ilir Krasniqi, Ismet Hajrizi, Kushtrim Hyseni, Hysni Gërguri Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Selim Rrustemi, Melihate Basholli-Latifi, Suzana Sylja, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkryetari i komunës z. Besim Muzaqi, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësuesit e KFOR-it dhe zyrtar tjerë kompetent komunal.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë të pranishëm 35 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrjen e vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës-në paraqitjen e tij para kuvendit, falënderoi të gjithë për bashkëpunimin e veçanërisht grupet kuvendare për konstruktivitetin dhe produktivitetin që kanë treguar gjatë vitit 2020, i cili ishte një vit shumë sfidues në përballje me pandeminë globale të quajtur covid-19. Tutje ai paraqiti një rezymë të shkurtër lidhur me punën dhe projektet e realizuara gjatë vitit 2020, duke shtuar se në muajin mars pas shfaqjes së pandemisë është themeluar shtabi i komunal i krizës, i cili në bashkëpunim me akteret dhe institucionet tjera ka bërë më të mirën e mundshme për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë. Sa i përket pandemisë njoftoi se që nga muaji mars e deri me 25 dhjetor 2020, kemi gjithsej 1605 të infektuar, të shëruar janë 1305, raste të vdekjeve 47 për çka familjeve të këtyre viktimave ju shprehu ngushëllime, ndërsa raste aktive deri me këtë datë janë 253. Në vijim ai duke ju referuar shifrave njoftoi se deri në momentin që po flasim realizimi i buxhetit është bërë në masën 82 % pa llogaritur realizimin e buxhetit në paga dhe mëditje për muajin dhjetor të këtij viti kur niveli i realizimi do të shkonte në 85 %. Realizimi i projekteve kapitale është bërë në masën 74 %, por që pritet realizimi i një pagese ku do ti afrohem 76 % realizimit të buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale. Në fund ai shprehu kënaqësinë e tij për realizimin e projekteve të parapara në buxhetin e komunës edhe përkundër faktit se viti 2020 ishte një vit i rënd në përballje me pandeminë covid-19.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-ngriti shqetësimin e tij dhe banorëve të fshatit Nadakoc, për fillimin e punimeve për ngritjen e një depo të patateve, ndërtimi i të cilës dhe caktimi i lokacionit është duke u bërë në mënyrë të kundërligjshme. Ndërsa në buxhet është e vërtetë se ka qenë e paraparë një kod buxhetor për ngritjen e kësaj depo për ruajtjen e patates në fshatin Pestovë, por që nuk është ditur lokacioni. Në këtë kontekst kuvendi nuk ka pasur propozim nga ana e qeverisë për caktimin e këtij lokacioni për ndërtimin e kësaj depo. Ndërsa komuna ka filluar procedurat e prokurimit në ç' rast është caktuar operatori ekonomik dhe këto proceduar janë zhvilluar pa një vendimi paraprak të kuvendit të komunës, pasi kjo çështje bie në kompetencë ekskluzive të kuvendit. Fillimisht ky projekt kishte filluar në realizohej në oborrin e shkollës në fshatin Pestovë, por aty kishte pasur rezistencë dhe kundërshtim nga banorët lokal, dhe me të njëjtën kontratë është bërë zhvendosja e lokacionit në oborrin e shkollës në fshatin Nadakoc, kjo është tepër shqetësuese sepse askund nuk lejohet që në oborret e shkollave të caktohen depo për ruajtjen e patates, kjo aq më tepër ku kundërmimi i patates do të ndikonte direkt në pengimin e procesit mësimor dhe do ta rrezikonte seriozisht shëndetin e nxënësve. Lidhur me këtë problematik ai kërkoi që kjo çështje të fute në rend të ditës për tu marrë një vendim për ndërprerje e punimeve në ndërtimin e kësaj depo të patates në oborrin e shkollës në fshatin Nadakoc. Ai shtoj se ka informacione se kjo depo është tentuar të vendoset në një pronë private në fshatin Dobërlukë dhe kjo është një lojë e rrezikshme dhe papërgjegjësi totale. Në rastin konkret kemi të bëjmë me shkelje të procedurave ligjore, tejkalim të autorizimeve dhe kompetencave dhe anashkalim të kuvendit, pasi ai e ka kompetencën ligjore për të vendosur për caktimin e lokacioneve për ngritjen e godinave dhe ndërtesave tjera. Në këtë kontekst kemi të bëjmë me punë kundërligjore dhe për këtë ftoj autoritetet prokurorinë e shtetit që të merret me këtë rast.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës-tha se ky projekt është ngritja e depos për ruajtjen e patates, për prodhuesit lokal të asaj zone, deri sa ato produkte të dalin në treg. Nuk bëhet fjalë për ndonjë deponi patatesh e cila do të kundërmonte por kemi të bëjmë me depo për ruajtjen e saj. Në gjykimin e tij ka pasur nxitej politike për ta kundërshtuar një projekt të tillë, i cili është projekt me bashkëfinancim me qytetarët e Vushtrrisë me bujqit prodhues të asaj zone. Këta prodhues do të përfitonin nga ndërtimi i këtij objekti vlera e të cilit është 120,000.00 € që është grant nga ministria, ndërsa pjesa tjetër është që participon Komuna e Vushtrris. Ndërtimi i kësaj depo të patates, mund ta pengon dikë që ka monopol të ruajtjes së patates, por kjo nuk i pengon banorët e asaj zone, për këtë problematikë ka pasur takime me Këshillin e Fshatit, takime të gjëra me banorët, por takim edhe në zyrat e komunës me përfaqësuesit e këshillave të fshatrave për këtë ka pasur pajtueshmëri nga këta të fundit. Lokacioni ku është caktuar për ngritjen e kësaj depo është një hapësirë e madhe ku gjendet edhe objekti i HANDIKOSIT, dhe kjo pronë është në pronësi të komunës. Në këtë kontekst ai vlerësoi se ky projekt është i mirëseardhur dhe do të ndikoj pozitivisht për prodhuesit e patates, në asnjë formë nuk do të rrezikohet procesi mësimor jeta dhe shëndeti i nxënësve, ai ftoj të përkrahet ky projekt dhe mos të kemi nxitje për rezistencë e kundërshtimi të banorëve.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se është shqetësues fakti se si nënkryetari i komunës tenton të arsyetoj disa veprime të qeverisë komunale, konkretisht të kryetarit të komunës, veprime të cilat janë të kundërligjshme, dhe kjo për faktin se kur i kthehemi kujtesës jo të largët kur kishte pyetur kryetarin e komunës se përse nuk po ndërtohet lapidari i dëshmorëve të Batalionit të I të Brigadës 142 ZOSH, ishte arsyetuar se ai është i gatshëm të realizoj këtë projekt, por kuvendi nuk ka marr vendim për caktimin e lokacionit. Tani kryetari i komunës pa pyetur fare kuvendin merr vendim për caktim lokacioni të depos së patates në fshatin Pestovë, por që hasë nuk kundërshtim të banorëve të këtij fshati, mandej vendos që me dy punëtor vartës të kryetarit, të ashtuquajtur përfaqësues të Këshillit të Fshatit lidhë marrëveshje që ky objekt të ndërtohet në Nadakoc. Andaj

vlerëson se është i trishtueshme fakti që tentohet të mbrohet diçka që është e kundërligjshme, por pret nga nënkryetari i komunës që deklaron se veprimet e kryetarit kanë qenë të gabuara.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit- tha se duke qene se jam përfaqësuese e atyre fshatrave në Kuvendin Komunal, e ndjeva obligim të diskutoj, edhe pse përveç këtij diskutimi, ka afërsisht një javë që jam marr me këtë çështje. Ne të gjithë e digjmë që qyteti i Vushtrisë njihet si qyteti që kultivon më së shumti patate dhe kur kam dëgjuar për këtë projekt jam gëzuar duke qenë se shumë kultivues të patates nuk kanë ku të deponojnë patatet e tyre. Thënë të drejtën edhe unë kam qene pak skeptike sa i përket lokacionit dhe në momentin që kam dëgjuar që kjo depo po ndërtohet në afërsi të shkollës në të cilën edhe vet kam vijuar mësimin kohe më parë, kam takuar kryetarin e komunës, nënkryetarin dhe drejtorët kompetent. Pas kësaj, e kam parë te arsyeshme që këtë vendim mos ta lëmë vetëm në dorën e kryetarit apo timen, kështu kam marr një iniciative për koordinim me kryetaret e këshillave të atyre fshatrave, Mavriq, Sfaraqak, Nadakoc. Pas takimit me përfaqësuesit e këshillave të fshatrave, e patëm organizuar një takim me banoret e këtyre fshatrave, ku prezent ishte edhe kryetari i Komunës. Debati është shterë në atë takim dhe pas atij takimi i'u kemi lënë në dorë që të vendosin kryetaret e fshatrave tutje e të cilët kanë mbajtur edhe një takim nga i cili ka dal edhe një zotim i shkruar nga kryetari. Përmes këtij fjalimi desha të njoftoj që ky projekt nuk po ndodh pa dijeninë e banoreve të atyre fshatrave dhe uroj të jete projekt produktiv për Komunën e Vushtrisë.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se vërtet është shqetësues paraqitja e nënkryetarit të komunës, i cili duke krijuar insinuata, tenton të krijoj gjendje jo reale. Kjo për faktin se nuk qëndron konstatimi se ministria ka participuar me 140,000.00 €, por është 60,000.00 €, ku 70,000.00 € participon komuna në fazën e parë, ndërsa në vitin e ardhshëm paguhet pjesa shtesë prapë nga buxheti i komunës në vlerën totale të këtij projekti prej 159,000.00 €. Sa i përket lokacionit konstatoj se është kompetencë ekskluzive e kuvendit që të marrë vendim për caktimin e lokacionit të objekteve komunale të çfarëdolloj destinimi që janë ato. Pastaj deklarimi i nënkryetarit se dikush ka tendencë për ta ruajtur monopolin sa i përket patates dhe ruajtjes së saj është i paqëndrueshëm, kjo për faktin se në Pestovë dhe Doberllukë ka qe shumë depo për patate të cilat në shumicën e kohës janë të zbrazëta., dhe kështu kjo depo nuk ka pasur fare nevojë të ndërtohet. Andaj përsërit se shkeljet ligjore ekzistojnë sa i përket caktimit të lokacionit, ndërtimi pa leje ndërtimore, mos respektimit i dispozitave kontraktuese etj, për të gjitha këto ftoj organet e drejtësisë prokurorinë e shtetit që të merret me hetimin e këtyre shkeljeve, dhe që nënkryetari i komunës tu kërkoj falej anëtarëve të kuvendit dhe qytetarëve të Vushtrisë.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës-tha se pa dashur që ti jepet konotacion politike apo tjetër fare ky projekt është tepër i mirëseardhur për qytetarët dhe prodhuesit e patates të Komunës së Vushtrisë. Në këtë kontekst ai shprehu se ata që folën për pazare më së paku e kanë kredibilitetin për të folur. Ky projekt është i një niveli tepër të avancuar që dallon nga depot tjera për ruajtjen e patates si i tillë është tepër i nevojshëm për prodhuesit e patates, andaj të dilet kund këtij projekti dhe ta kritikosh është e papranueshme.

Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit-tha se dëshiron të sqaroi se si grup kuvendar nuk janë kundër projekteve që janë në të mirë të qytetarëve, por që ato të kryhen për qytetarët dhe sipas ligjit. Kërkoj nga qeveria komunale, kryesisht nga Drejtori i Arsimit i Shëndetësisë dhe Bujqësisë, që këtë pikë grumbulluese të shumë prituri dhe të nevojshme ta vendosin aty ku e ka vendin e jo në oborrin e shkollës. Ajo pastaj vlerësoi se këto veprime i bëjnë atë të cilët shkollën e shikojnë vetëm si objekt pa analizuar se kush është brenda saj. Në këtë kontekst ceku se pjesa e pashfrytëzuar e oborrit të shkollës ku gjendet edhe qendra e HANDIKOSIT, në Nedakoc, duhet të bëhet funksionale, ndërsa për depon e patates të gjendet një vend tjetër adekuat.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-përsëriti se kompetencat e kuvendit janë ekskluzive sa i përket caktimit të lokacionit për ndërtimin e objekteve komunale e në rastin konkret edhe për depon e patates, andaj në rastin konkret qeveria komunale (kryetari i komunës) ka bërë shkelje ligjore sa i përket kësaj çështje.

Afrim Namani, drejtor i DA-së-duke ju referuar diskutimit të znj. Basholli, pyeti atë se ku ka qenë kur pushteti i kaluar atë lokacion që po ndërtohet depoja, i është dhënë në shfrytëzim një operatori ekonomik për shërbime me automarimang. Aty është vendosur që ofrohen shërbimet e tilla, janë prerë pemët (bagrenat) është vendosur zalli, por më vonë ka pasur reagim të komunitetit dhe është ndërprerë ai aktiviteti, i operatorit ekonomik i cili ishte vendosur me vendim të kuvendit.

Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit-vlerësoi se nëse është bërë një gabim në të kaluarën nga kushdo qoftë ai, atëherë kjo nuk justifikon përsëritjen e gabimit të njëjtë nga një pasardhës në pushtet, edhe pse u sqarua se aktiviteti me automërimëng është ndërprerë nga ana e kuvendit. Sido që të jetë fuqishëm e kundërshton idenë që në oborrin e shkollës të vendoset ndërtimi i depo së patates, për këtë të gjendet një hapësirë tjetër e përshtatshme.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës-tha se dëshiron të flasë për ata të cilët dunë të kuptojnë drejt, e jo për ata që kundërshtojnë çdo gjë, me realizmin e këtij projekti ajo parcelë do të jetë shfrytëzim publik për qytetarët në mënyrë të përhershme, tendencat tjera që kjo parcelë të jepet kujtdo tjetër për shfrytëzim privat tashmë kanë përfunduar.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit-tha se duke parë nervozizmin e madh të anëtarëve të qeverisë, kjo bënë të ditur se në këtë çështje ka një interes të madh dhe kësaj ku ja shtojmë faktin se caktimin e lokacionit e ka kundërshtuar edhe komuniteti lokal, e bënë këtë çështje edhe më komplekse. Pastaj shtoi se parimisht është <për> që të krijohen kushtet për prodhuesit e patates duke e ndërtuar edhe atë depo për ruajtjen e saj, por që ajo të bëhet në vend të përshtatshëm dhe brenda suazave ligjore. Ai përsërit mendimin e tij për si siç deklaroi: se qeveria komunale i trajton anëtarët e kuvendit sikurse delet, duke mos i pyetur fare dhe duke u përzier në kompetencat e kuvendit, kjo vërtetohet pikërisht me caktimin e lokacionit për depon e patates në Nadakoc. Ai vlerësoi se PDK-ja në Vushtrri asnjëherë nuk ka dal kundër interesave të qytetarëve, dhe se gjithëherë ka shtrirë dorën e bashkëpunimit, me qeverinë e komunës por që asnjëherë nuk ka arritur të bashkëpunoj me të për të arritur një qëllim të përbashkët për shkak të arrogancës dhe paafësisë së kësaj qeverie. Personalisht është që të ndërtohet kjo depo e patates, ashtu që të rritet vlera e saj në treg, dhe të mbrohen prodhuesit tanë, por që kjo të bëhet brenda suazave dhe procedurave ligjore që përcaktohen me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale. Pastaj ceku se nuk është mirë që debati të orientohet diku tjetër, dhe nëse dikush ka informacion por edhe nënkryetari i komunës që ka të bëjë me monopol interesash të dikujt atëherë le të deklarohet me emër ashtu që të gjithë të distancohemi. Nëse lokacioni tek shkolla e fshatit Nadakoc, nuk është i përshtatshëm, ai mendon se mund të shfrytëzohet hapësira e pronës tek shkolla e fshati Maxhunaj ku është një hapësirë bukur e madhe dhe nëse vlerësohet se aty nuk pengohen nxënësit atëherë kjo hapësirë do të mund të shfrytëzohej për ndërtimin e kësaj depo. Lidhur me këtë ai ceku se nuk është mirë të flitet vetëm sa për të thënë diçka por të flitet me fakte, sepse të gjithë e dinë se qeveria aktuale e komunës është tërësisht e korruptuar dhe këtë e dinë gjithë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë, keqpërdorimet konsistojnë edhe në te ndera dhe në konkurse publike për çka ftoj prokurorin që të merret me këto raste.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit-prezantoi rendin e ditës duke i inkuorporuar pika shtesë të cilat janë proceduar për futej në rend të ditës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-propozoi që të futet në rend të ditës propozim-vendimi për ndërprerjen e punimeve në ndërtimin e depos për ruajtjen e patates në fshatin Nedakoc. Ndërsa sa i përket propozim-vendimit për anulimin e vendimit e viteve të para luftës, sqaroi se edhe mandatin

e kaluar është trajtuar kjo çështje, dhe në atë kohë ishte themeluar një komision nga kuvendi dhe qeveria komunale, ku kishim diskutuar për kthimin e atyre pronave por që nuk kishin gjetur mirëkuptimin e zyrtarëve të shërbimit korrektues. Ai shtoi se shërbimi korrektues është pronar i këtyre pronave, dhe vendimi i kuvendit për ti kthyer në pronësi të komunës këto prona është i kundërligjshëm. Ai propozoi që nëse komuna dëshiron ti kthej këto prona në pronësi të saj atëherë duhet ti ndjek rrugët gjyqësore. Ai më tej vlerësoi se ky propozim është proceduar, pa u kompletuar me listat poseduese dhe kopjet e planit, ku evidentohet pronësia e këtyre pronave ashtu që pronar ekskluziv është Shërbimi Korrektues në Smrekonicë, kjo është bërë me qëllim që vuhet në lajthitej kuvendi, dhe propozoi që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës.

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-duke ju referuar parafolësit të tij sqaroi se fjala është për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër protokollit 01.Nr. 363/18 i datës 27.12.2018 me cilin ishte anuluar konkluzion për dhënien në shfrytëzim të pronave të komunës shërbimit Edukues Korrektues në Smrekonicë, një vendim i tillë ishte vlerësuar si i kundërligjshëm nga Ministria e Pushtetit Lokal, dha tani proceduralisht duhet të shfuqizohet. Pastaj ai propozoi që të futet në rendi të ditës propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit paraprak me numër të protokollit 01Nr.239/20 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se afati i MAPL-së për të kthyer përgjigje për ligjshmërinë e akteve është 15 ditë, dhe është dashur të priten 2 vite për të ardhur në kuvend për ta shfuqizuar këtë vendim, mandej pyeti se a ka ndonjë padi ndaj komunës lidhur me këtë çështje.

Në vazhdim kryesuesi i kuvendit e hodhi në votim propozim-vendimin për ndërprerjen e punimeve në ndërtimin e depos për ruajtjen e patates në fshatin Nedakoc, të parashtruar nga anëtarit i kuvendit z.Ilmi Azemi, i cili mori 11 vota "për" 16 vota "kundër", 1 votë "abstenim" dhe si tillë nuk futet në rend të ditës.

Pas votimit kuvendit me 18 vota "për" 2 vota "abstenim" të tjerët nuk morën pjesë në votim vendosi që të bëhet pjesë e rendit të ditës Draft-Rregullorja për përcaktimin e procedurave të dhënies së pronës komunale në shfrytëzim për periudhën më pak se një vit.

Pas votimit kuvendi me 19 vota "për", 9 vota "kundër" të tjerët nuk morën pjesë në votim, vendosi që të bëhet pjesë e rendit të ditës Propozim-vendimi për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të komunës Nr.363/18 i datës 27.12.2018 me të cilën është anuluar konkluzioni me numër të protokollit 12 Nr.465-18 i vitit 1984.

Pas votimit kuvendi me 19 vota "për" 9 vota "kundër" të tjerët nuk morën pjesë në votim, vendosi që të bëhet pjesë e rendit të ditës Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër të protokollit 01nr. 240/20 datë 26.11.2020, për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave dhe për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në parkun Industrial në Lumadh.

Pas votimit kuvendit me 19 vota "për" 9 vota "kundër" të tjerët nuk morën pjesë në votim, vendosi që të bëhet pjesë e rendit të ditës Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit paraprak me numër të protokollit 01Nr.239/20 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh.

Pas votimit të këtyre pikave të rendit të ditës, grupi kuvendar i PDK-së në mënyrë demonstrative i braktisë punimet e mbledhjes plenare të kuvendit, në sallë janë prezentë 19 anëtarë të kuvendit kuorum i mjaftueshëm për vazhdimin e punimeve të mbledhjes dhe për marrjen e vendimeve të plotfuqishme.

Në fund të debatit për rendin e ditës, Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë me 19 vota “për” aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 26 nëntor 2020;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës, mbajtur më 7 dhjetor 2020;
3. Shqyrtimi Draft-Rregullores për realizimin e të drejtave, përkujdesjen, mbrojtjen dhe parandalimin e punëve të rënda për fëmijë **(shqyrtimi i dytë)**;
4. Shqyrtimi i Draft-Planit të Punës së Kuvendit të Komunës të Vushtrrisë për vitin 2021;
5. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen sociale – shërbimet sociale, dhe ato të asistencës të Komunës së Vushtrrisë për periudhën janar – nëntor 2020;
6. Shqyrtimi i Informatës për ndarjen e bursave;
7. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës i Kryetarit të Komunës për vitin 2021;
8. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2021;
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për shpalljen e konkursit publik për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial në Lumadh;
10. Shqyrtimi i Draft-Strategjisë për Komunikim me publiku në Komunën e Vushtrrisë **(shqyrtimi dytë)**;
11. Shqyrtimi i Draft - Strategjisë Zhvillimore të Komunës për vitet 2020 – 2025 **(shqyrtimi dytë)**;
12. Shqyrtimi i Draft – Strategjisë të përkrahjes së prodhuesve në Komunën e Vushtrrisë **(shqyrtimi dytë)**;
13. Të ndryshme.
14. Shqyrtimi Draft-Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies së pronës komunale në shfrytëzim për periudhën më pak se një vit;
15. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të komunës Nr.363/18 i datës 27.12.2018 me të cilën është anuluar konkluzioni me numër të protokollit 12 Nr.465-18 i vitit 1984;
16. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër të protokollit 01nr. 240/20 datë 26.11.2020, për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave dhe për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në parkun Industrial në Lumadh;
17. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit paraprak me numër të protokollit 01Nr.239/20 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 26 nëntor 2020;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 26 nëntor 2020.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës, mbajtur më 7 dhjetor 2020;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit, e datës 7 dhjetor 2020.

3. Shqyrtimi Draft-Rregullores për realizimin e të drejtave, përkujdesjen, mbrojtjen dhe parandalimin e punëve të rënda për fëmijë (shqyrtimi i dytë);

Remzije Zekolli, zyrtare për Barazi Gjinore-propozoi që kjo rregullore të aprovohet me rekomandimet e bëra në dëgjim publik nga organizata ATRC, si dhe dy propozime tjera të bëra nga të pranishmit që kanë qenë në diskutim publik.

Pas shqyrtimit kuvendi me vota “unanime” aprovoj Rregulloren për realizimin e të drejtave, përkujdesjen, mbrojtjen dhe parandalimin e punëve të rënda për fëmijë, me rekomandimet e paraqitura nga organizata ATRC.

4. Shqyrtimi i Draft-Planit të Punës së Kuvendit të Komunës të Vushtrrisë për vitin 2021;

Pas shqyrtimit kuvendi me vota “unanime” aprovoj Draft-Planin e Punës të Kuvendit të Komunës të Vushtrrisë për vitin 2021.

5. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen sociale – shërbimet sociale, dhe ato të asistencës të Komunës së Vushtrrisë për periudhën janar – nëntor 2020;

6. Shqyrtimi i Informatës për ndarjen e bursave;

7. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës i Kryetarit të Komunës për vitin 2021;

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës-tha se plani i punës i kryetarit të komunës dhe qeverisjes komunale, paraqet objektivat dhe aktivitet e punës të qeverisë komunale për vitin 2021. Ky plan është fleksibil dhe i njëjti mund të ndryshohet gjatë vitit 2021 nëse paraqiten nevojat dhe rrethanat e caktuara. Përmes këtij plani ne do të mund të parashohim nismat për planifikimin e objektivave dhe caktimin e prioriteteve të cilat do të mund të realizohen në bazë të planifikimit buxhetor të viti 2021. Në realizimin e këtyre objektivave do të mund të ketë sfida ashtu siç kishte edhe këtë vit, me shpresë që do të tejkalohet pandemia covid-19. Në vazhdim në pika të përmbledhura paraqiti prioritetet kryesore të planit qeverisë për vitin 2021: rimëkëmbja ekonomike nga pandemia covid-19 do të jetë top prioritet i qeverisjes komunale, do të vazhdohet me kyçjet në rrjetin e ujësjellësit të gjitha familjeve në të gjitha vendbanimet aty ku është shtrirë rrejtja primar dhe do të vazhdohet me ndërtimin e rrjetit sekondar, ndërsa do të gjendet zgjidhje për ato vendbanime ku

presoni i ultë i ujit përmes pompave, qoftë përmes burimeve alternative, prioritet tjetër do të jetë mbështetja në funksionalizimin e ndërmarrjeve publike siç është kompania publike “Përparimi” e cila tash më është themeluar nga kuvendit i komunës, funksionalizimi i parkut industrial në Lummadh, i cili është një ndër projektet më të mëdha të cilin kjo qeveri e ka gjetur në sirtar që nga viti 2009 por që tashmë ky projekt është duke marrë formën finale. Pastaj sigurimi i lokacionit të stacionit të autobusëve do të jetë njëra ndër objektivat e ardhshëm, gjetja e mundshme e donatorëve për ndërtimin e tregut për prodhuesit vendor, e që komuna veç kishte lidhur një marrëveshje me Qeverinë e Katarit për realizimin e këtij projekti por që pandemia e ka stopuar këtë projekt. Menaxhimi efektiv dhe transparentë i buxhetit të komunës është prioritet i qeverisë komunale, pastaj transparenca dhe llogaridhënia administrative para qytetarëve, raportimi i rregullt i qeverisë përpara kuvendit në perioda tre mujore për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore sipas nevojës dhe kërkesës së kuvendit. Implementimi sipas planifikimit i projekteve kapitale, dhe realizimi efektiv i shpenzimit të buxhetit në investime kapitale sidomos shpenzimi i mjeteve financiare nga granti qeveritar. Angazhimet për realizimin e të hyrave vetanke në masën e planifikuar apo tejkalimi i tyre. Do të vazhdohet në përmirësimin e infrastrukturës sportive e rekreative dhe infrastrukturës në përgjithësi. Qendra Inovative e Vushtrrisë po ashtu është një projekt të cilin do ta bëjmë realitet. Ndërtimi i Qendrës për Qëndrim Ditor për të moshuarit është një tjetër objektivë, finalizimi i Muzeut të Qytetit gjithashtu do të jetë prioritet që do ta konsolidoj infrastrukturën kulturore të Vushtrrisë. Ndërtimi i parqeve dhe hapësirave publike si dhe shtrirja e rrjetit të ndriçimit po ashtu do të jetë prioritet. Do të vazhdohet me rregullimin e shtratit të lumit “Silnica” në pjesën e segmentit të qytetit, do të vazhdohet në projektin e rregullimit të shtratit të lumit “Podrança” i cili është afër përfundimit dhe i cili po e zbkuron qytetin, ndërtimi i urave aty ku është e nevojshme. Do të vazhdohet me instalimin e kamerave të qytetit, të cilat tashmë në shumicën e hapësirave janë funksionale. Ndërtimi i çerdheve, ngritja e bashkëpunimit me organet e pushtetit qendror në implementimin e projekteve të cilat janë të financuara nga niveli qendror. Shfrytëzimi sa më racional i pronës tokave dhe objekteve në pronësi të komunës sa i përket dhënies në shfrytëzim. Ndërmarrja e masave për lirim dhe pronave komunale, dhe publikimi i listës i gjithë uzurpatorëve të pronës publike dhe komunale. Angazhimet për gjetjen e donatorëve dhe investitorëve për projekte të reja qoftë përmes bashkëpunimeve ndërkomunale qoftë përmes bashkëpunimeve OJQ dhe organizata ndërkombëtare. Rritja e prodhimtarisë bujqësore, përmirësimi i cilësisë të atyre prodhimeve përmes ndihmave direkte dhe përmes përgatitjes së infrastrukturës për prodhuesit. Organizimi i trajnimeve profesionale që do ta rritë performancën e zyrtarëve komunal. Kujdesi për një ambient të pastër është një tjetër objektivë. Avancimi i aspektit të menaxhimit të mbeturinave i cili është duke u marrë si storie suksesi nga shumë komuna të Republikës së Kosovës. Gjithëpërfshirja në arsim dhe ngritja e cilësisë së punës të institucioneve të arsimit është objektiv shumë e rëndësishme sidomos pas një viti me pandemi si vit shumë sfidues. Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore të cilat si asnjëherë më parë janë ngritur në komunën e Vushtrrisë

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se ky plan i punës i kryetarit të komunës, është krejtësisht i stilit copy-past, nga vitet e kaluara, me përjashtim se nga mbledhja e KPF-së i janë ndryshuar datat. Krejtësisht i njëjtë për faktin se këto prioritet e objektiva kanë qenë edhe në vitet 2018-2019-2020 dhe tani e për vitin 2021. Shembulli vjen qëndrimi ditor për të moshuarit ka qenë prioritet edhe i pushtetit të kaluar e lëre më për këto vitet e fundit që ka qenë në vazhdimësi i përsëritur. Pastaj Qendra Inovative e Vushtrrisë ka qenë gjithë prioritet por nuk është realizuar. Ndërtimi i çerdhes sa për të shkruar diçka në letër. Por le të ndalemi pak tek projekti ndërtimi i stacionit të autobusëve që u proklamua si prioritet, këtu mos kemi kundërshtim me kryetarin e komunës, për

faktin se në mbledhjen e kaluar kryetari i komunës ka deklaruar se: prona tek ish-vicianumi, pronë e Ministrisë së Drejtësisë e cila është dhënë në shfrytëzim nga kjo e fundit në saj të marrëveshjes i është lënë qiramarrësit që ai ta ndërtoj stacionin ndërsa komuna të paguaj qira. Propozimi i kryetarit të komunës kishte qenë variable sa më mirë kishte me qenë që komuna ta ndërtoj vet stacionin, apo që ai operator ekonomik ta ndërtoj stacionin e autobusëve, ndërsa komuna e merr me qira këtë objekt, ndërsa tani nënkryetari i komunës po deklaroi se është prioritet i komunës që ta caktoj lokacionin për stacionin e autobusëve në vitin 2021.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës-tha se ajo çka është shumë e rëndësishme është që qytetarët të kenë stacionin e autobusëve. Për pronën të cilën u fol këtu është pronë e Ministrisë së Drejtësisë të cilën me ngulm komuna ka kërkuar që ti kthehet por kjo nuk ka ndodhur dhe menaxhimi është bërë ashtu siç ka menduar Drejtoria e Burgjeve dhe e ka dhënë shfrytëzim por qe qeveria komunale nuk qasje për atë se si është dhënë në shfrytëzim kjo pronë

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-sqaroi se për pronën e cila është objekt diskutimi është e vërtetë që kuvendi ka marrë një vendim paraprak që të shpallet zonë me interes të përgjithshëm, dhe e vërteta është se në të gjitha takimet që kanë pasur kanë kërkuar nga Ministria e Drejtësisë që ajo pronë të mos jepet në shfrytëzim. Në kontratën të cilën e ka nënshkruar Drejtoria e Burgjeve decidivisht thuhet se operatori ekonomik do ta ndërtoj stacionin e autobusëve, ndërsa me mjetet të cilat i kemi ndarë për këtë destinim do të mund të paguhet qiraja për këtë objekt për disa vite.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-pyeti se a ka dikush ndonjë informacion që në Ligjin për aprovimin e Buxhetit të Kosovës për vitin 2021, a është futur ndonjë amendament i kërkuar nga ana e kryetarit të komunës së Vushtrrisë, dhe i përfaqësuesve tanë në Kuvendin e Kosovës që lidhen me projektet për Komunën e Vushtrrisë.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, pas votimit kuvendi me 20 vota “për” 1 votë “kundër” aprovoj Planin e Punës të Kryetarit të Komunës për vitin 2021.

8. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2021;

Pas shqyrtimi të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi me vota “unanime” aprovoj Planin e Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2021.

9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për shpalljen e konkursit publik për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial në Lumadh;

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-sqaroi se për këtë konkurs në mbledhjen e kuvendit të muajit të kaluar janë dhënë disa propozime, të cilat disa janë aprovuar ndërsa disa jo. Por gjatë procedurës së votimit ka pasur një lëshim procedural pasi që konkursi si tërësi nuk ishte votuar. Pas votimit të këtij konkursi afati i aplikimit do të zgjatë për 30 ditë, nga dita e shpalljes, ndërsa konkursi paraprak do të anulohet, kurse aplikantët e mëhershëm duhet të ripërtërijnë aplikacionet dhe dosjet e tyre aplikuese, sipas konkursit të rishpallur.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit-kërkoj që në kuadër të këtij vendimi të futet një pikë që e shfuqizon konkursin paraprak lidhur me vendosjen e bizneseve në parkun Industrial në Lummadh.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se e vërteta është se kuvendi nuk e kishte votuar propozimin për shpalljen e konkursit në mbledhjen e kuvendit, ndërsa kryesuesi ka nënshkruar një vendim të kundërligjshëm të cilin duhet patjetër ta anulojmë sot.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës-tha se në kuadër të këtij vendimi, të futet një pikë që e shfuqizon konkursin paraprak, ndërsa operatorët ekonomik të cilët kanë aplikuar, të vijnë edhe njëherë në komunë për ta përsëritur aplikimin e tyre.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, pas votimit kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

Vendndodhja: Fshati Lumadh Komuna e Vushtrisë, kilometri i 18-të, në rrugën nacionale Prishtinë – Mitrovicë.

Parcelat: P-70202011-00435-1, në sipërfaqe prej 8.77.90 ha, dhe parcela kadastrale P-70202011-00435-3 me sipërfaqe prej 6,08.10 ha.

Madhësia e parcelave: varësisht nga kërkesat e subjekteve afariste, zona e parë (I) deri në 50 ari, zona e dytë (II) prej 50 ari deri në 1 hektarë dhe zona e tretë (III) mbi 1 hektarë.

Veprimtaritë e lejuara në parkun industrial: Në parkun industrial mund të zhvillohet çdo veprimtari afariste e cila nuk cenon rendin publik, mbrojtjen e shëndetit publik, mjedisin, florën dhe faunën dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Përparësitë për vendosje në parkun industrial: Me rastin e shqyrtimit të aplikacioneve përparësi do të kenë ato biznese të cilat merren me veprimtari prodhuese, përpunimit të produkteve si dhe ato të cilat rrisin numrin e punëtorëve në raport me numrin ekzistues të biznesit.

E drejta e aplikimit: Të drejtë aplikimi kanë të gjitha bizneset vendore dhe të huaja të cilat plotësojnë kushtet dhe kriteret që janë të përcaktuara në konkurs, që kanë për qëllim zhvillimin dhe zgjerimin e kapaciteteve biznesore dhe rritjen e zhvillimit ekonomik.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim: Me rastin e aplikimit për të u vendosur në park industrial të interesuarit duhet dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i plotësuar me të dhënat e kërkuara
- Certifikata e regjistrimit të biznesit
- Historiati i kompanisë (biznesit)
- Veprimtaria që do ta zhvilloj
- Projekti ideor

Bizneset e aprovuara në parim brenda afatit kohorë prej 30 (tridhjetë) ditësh duhet të sjellin dokumentacionin në vijim:

- Vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës për përmbushjen e obligimeve tatimore
- Dëshminë nga ATK për numrin aktual të të punësuarve
- Planin e Biznesit
- Garancionin bankar prej 5% të vlerës së parashikuar të investimit me rastin e nënshkrimit të kontratës

Kriteret për vlerësim:

Punësimi 40 pikë;

Vlera investive 30 pikë;

Lloji i veprimtarisë 30 pikë;

- *Prodhuese 30 pikë,*
- *Përpunuese 20 pikë,*
- *Shërbyese 10 pikë,*

Afati i dhënies në shfrytëzim – nëntëdhjetë e nëntë (99) vite nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Tërheqja e formularit:

Formulari për aplikimit mund të merret në zyrën pritëse të komunës – kati përdhes çdo ditë pune nga ora 8;30 deri në ora 15;30, ose në faqen zyrtare të komunës.

Dorëzimi i dokumentacionit:

Formulari i plotësuar së bashku me dokumentacionin tjetër të kërkuar me konkurs duhet dorëzuar në mënyrë fizike në zyrën pritëse të komunës (në pliko të mbyllura të vulosura me vulën e biznesit), i cili i adresohet Komisionit për Vlerësimin e Ofertave dhe për Zbatim të Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Afati i për aplikim: Konkursi do të jetë i hapur 30 ditë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Vërejtje: aplikacionet e dorëzuara pas ditës së mbylljes së konkursit nuk do të merren në shqyrtim përveç atyre që arrijnë përmes postës të cilat mbajnë datën e fundit të caktuar në konkurs deri në ora 16;00.

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi i kuvendit të komunës për shpalljen të Konkursit Publik për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial në Lumadh me numër të protokollit 01.Nr.241/20 i datës 26.11.2020.

E drejta në ankesë: Bizneseve të cilave iu refuzohet e drejta për të u vendosur në parkun industrial kanë të drejtë ankesë komisionit të ankesave brenda 8 ditëve të punës.

10. Shqyrtimi i Draft-Strategjisë për Komunikim me publiku në Komunën e Vushtrrisë (shqyrtimi dytë);

Pas shqyrtimi të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet Strategjia Komunale për komunikim 2021-2023 e Komunës së Vushtrrisë.

2. Qëllimi i aprovimit të kësaj strategjie është përcaktimi i rregullave dhe standardeve në ngritjen e cilësisë së komunikimit me publikun, rritjen e transparencës në shërbimet që ofron komuna por koordinimin e aktiviteteve komunale sa i përket vendimmarrjes në raport me qytetarët.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra për Informim dhe Komunikim e Komunës së Vushtrrisë, dhe drejtorit tjera komunale.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Strategjia Komunale për komunikim 2021-2023 i Komunës së Vushtrrisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

11. Shqyrtimi i Draft - Strategjisë Zhvillimore të Komunës për vitet 2020–2025 (shqyrtimi dytë);

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit-paraqiti vërejtje lidhur me dokumentin në fjalë, në aspektin teknik e gjuhësor, por edhe në aspektin e mbarështrimit logjik të këtij dokumenti, kërkoj nga zyra e kryetari që ky dokument të korrigjohet.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha vërejtjet e tij të cilat i ka paraqitur më herët nuk janë inkorporuar në këtë dokument. Lidhur me këtë ai shprehu dëshirën e tij që autorët e këtij dokumenti të jenë prezent këtu por edhe koordinatori nga komuna e Vushtrrisë. Ai përsërit qëndrimin e tij se autori është thirrur në statut të komunës dhe i kanë inkorporuar 65 vendbanime por që Vushtrria i ka 67 vendbanime. Pastaj shtoi e sqaroi se Vushtrria në koordinatat gjeografike ndodhet në X1 dhe X2 20 dhe 21° e jo 200 dhe 210°, pastaj Vushtrria ndodhet në koordinatat gjeografike 42° 41' 20", e jo 420 ° dhe ka dyshime se me këtë "Vushtrria është zhvendosur në Siberi". Pastaj përsërit se është se disa herë ka kërkuar që ky dokument të spastrohet në aspektin e përkufizimeve në shkurtesa sa i përket gjuhëve ato ose duhet të jenë krejt në gjuhën shqipe ose në gjuhën angleze.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës-tha se duke parë që ky dokument ka aq shumë gabime qoftë edhe drejtshkrimore, dhe me qëllim që të del një dokument sa ma i kompletuar duhet korrigjohet, në mbledhjet vijuese të ti ofrohet kuvendit, për këtë ai kërkoj që ky dokument të shtyhet për ndonjë mbledhje të ardhshme.

Pas shqyrtimi të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi me vota "unanime" vendosi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

12. Shqyrtimi i Draft – Strategjisë të përkrahjes së prodhuesve në Komunën e Vushtrrisë (shqyrtimi dytë);

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit-paraqiti vërejtje tek plani për veprim, ku shënohet data e fillimit dhe e përfundimit duhet të modifikohet, data e fillimi dhe përfundimit është prill 2020. Pastaj në faqen 48 shuma e buxheti të planifikuar për implementim të strategjisë shuma të rregullta janë 130,000.00 € për vitin 2020, pastaj shkruhet se financim nga komuna kemi shumën 100,000.00 €. Pastaj thuhet kontributi në natyrë nga angazhimi i prodhuesve, dhe në fund thuhet bashkëfinancimi nga përfituesit e projekteve, kjo është e pa qartë se çfarë dëshirohet të arrihet në këto përkufizime në tabelën për vitet 2019-2023.

Pas shqyrtimi të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi me vota "unanime" vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet Strategjia Komunale për Përkrahjes së Prodhuesve në Komunën e Vushtrrisë

2. Qëllimi i aprovimit të kësaj strategjie është konsolidimi infrastrukturës juridike në aspektin e përkrahjes së prodhuesve vendor, si dhe përcaktimi i planit për zhvillim ekonomik lokal të Komunës së Vushtrrisë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: kryetari i komunës si dhe Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Plani Strategjik për përkrahje të Prodhuesve në Komunën e Vushtrrisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

13. Shqyrtimi Draft-Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies së pronës komunale në shfrytëzim për periudhën më pak se një vit (shqyrtimi dytë);

Pas shqyrtimi të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi me vota “unanime” aprovoj Rregulloren për përcaktimin e procedurave të dhënies së pronës komunale në shfrytëzim për periudhën më pak se një vit.

14. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të komunës Nr.363/18 i datës 27.12.2018 me të cilën është anuluar konkluzioni me numër të protokollit 12 Nr.465-18 i vitit 1984;

Pas shqyrtimi të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimit i kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01 Nr.363/18 i datës 27.12.2018, me të cilin është anuluar Konkluzioni i ish-kuvendit të komunës së Vushtrrisë 12 Nr.465-18, i datës 21.04.1984 për dhënien në shfrytëzim të pronave të komunës Shërbimit Edukues Korrektues në Smrekonicë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

3. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

15. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër të protokollit 01nr. 240/20 datë 26.11.2020, për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave dhe për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në parkun Industrial në Lumadh;

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-në adresimin e saj para kuvendit tha se seancën e kaluar të Kuvendit, tek pika për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave dhe zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, gjegjësisht për parkun industrial në

Stanoc, nga grupi Kuvendar i Lëvizjes Vetëvendosje u propozova unë që t'i përfaqësoi në atë komision. Subjektin tim politik e falënderoj shumë për besimin që e ka tek unë, qoftë edhe për procese kaq të rëndësishme dhe njëkohësisht e vlerësoj që Lëvizja VETËVENDOSJE!, çdoherë e ka parasysh edhe përfaqësimin gjinor andaj pa hezitim edhe e sheh të rrugës të na propozoj çdo kund. Në këtë seancë, pa u bërë më vonë duke ditur që kam informatë nga zyra ligjore se ndryshimi i anëtarëve të komisionit nuk paraqet problem për procedurat në vijim, deklaro hem se dua të tërhiqem nga ky komision, për arsyet që do i cekim më poshtë: Duke qene se unë, përveç punës në Kuvendin Komunal, ushtroj detyrën e profesionit tim si ekonomiste dhe kam kontratë të përhershme me kompaninë EDONA e cila potencialisht mund të ketë interes për hapësirë në parkun industrial, gjithashtu pozita të cilën e zotoj në atë kompani, më obligon të kem kontakt të përditshëm edhe me biznese tjera shërbyese, përpunuese e prodhuese. Gjatë hapësirës kohore nga seanca e kaluar, kam pranuar telefonata nga bashkëpunëtorët që shprehnin interes për hapësirë në parkun industrial dhe të cilët kërkonin nga unë sqarime shtesë për procedurat si vijojnë etj. Kësisoj, e vlerësova të rrugës se, për te qenë sa më korrekte me qytetarët, dhe në të ardhmen mos të paraqitet ndonjë konflikt interesi apo diçka e tillë, preferova të tërhiqem dhe i sugjerova subjektin tim politik, të më zëvendësoj me ndonjë anëtar tjetër. Projekti i parkut industrial është një ndër projektet më madhore në komunën e Vushtrrisë, dhe duke qenë i tillë, secili nga ne, qoftë nga ekzekutivi apo legjislativi duhet të kujdeset në maksimum që secila procedurë deri në përfundim të këtij projekti të jete e drejtë, e sa më transparente. Uroj në mirëkuptim nga secili prej jush, dhe nga secili qytetar por mendoj që ka anëtar të tjerë që nuk kanë kësso konflikti interesi dhe mund të kontribuojnë më shumë, për shkak të ndjeshmërisë së këtij projekti. Gjithashtu pas këtij fjalimi, shfrytëzoj rastin që secilit qytetar dhe koleg t'i uroj vit të suksesshëm dhe uroj që të mos kemi sfida siç kishim në vitin që po e lëmë pas.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës-propozoi që në vend të z. Refik Maloku të emërohet Miran Halili anëtar i komisionit për vlerësimin e ofertave dhe për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në parkun Industrial në Lumadh nga ekzekutivi komunal.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-propozoi z.Ymer Haradinajn për anëtar të komisionit për vlerësimin e ofertave dhe për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në parkun Industrial në Lumadh.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, pas votimit kuvendi me vota "unanime" vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet nënpika 1.3 dhe 1.6 e pikës 1 të vendimit të Kuvendit të komunës 01nr. 240/20 datë 26.11.2020, për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave dhe për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në parkun Industrial në Lumadh, ashtu që në vend të znj.Gresa Mulit anëtare e kuvendit emërohet Ymer Haradinaj po ashtu anëtar i kuvendit, ndërsa në vend të z.Refik Malokut, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, emërohet z.Miran Halili, drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: anëtarët e komisionit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

16. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit paraprak me numër të protokollit 01Nr.239/20 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh.

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-sqaroi se ndryshimi dhe plotësimi i këtij vendimi bëhet me qëllim të lëshimit të evitimit të një gabimi nga mbledhja e kaluar e kuvendit, konkretisht ndryshohet pika 2.1 e vendimit me numër të protokollit 01Nr.239/20 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh, ndryshimi konsiston se pagesa e qirasë nga operatorët ekonomik për metër katrori do të jetë 0.05 cent (pesë centë) për metër katror në vit.

Pas shqyrtimi të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet pika 2.1 e vendimit paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë me kompensim e pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh, me numër të protokollit 01Nr.239/20 i aprovuar nga kuvendi i Komunës së Vushtrrisë më datën 26.11.2020, ashtu që subjektet afariste, në tri (3) vitet e para nga data e nënshkrimit të kontratës me komunën, nuk do të paguajnë kompensim, ndërsa pas tri (3) viteve do të paguajnë 0.05 € (pesë cent) për m² në vit.

2. Pjesët tjera të këtij vendimi mbesin të pandryshuara.

3. Për zbatimin e këtij vendimit obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë si dhe Komisioni për Vlerësimin e Ofertave dhe për Zbatim të Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në ora 13:20.

Bastri Duraku


Procesmbajtës

Nasuf Aliu


Kryesues i Kuvendit